

KOMUNIKATË PËR MEDIA

31 janar 2007

AKM-ja shpall rezultatet e Raundit të Dytë dhe Final të Ofertimit me “Spin-off Special” për Ndër. e Re Morava e Binçës Gurëthyesi Sh.P.K., dhe Ndër e Re Mulliri Fushë Kosovë- Podujevë-Lipjan Sh.P.K.

Prishtinë – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) shpalli rezultatet e ofertimit të shitjeve me “Spin-off Special” për Ndër. e Re Morava e Binçës Gurëthyesi Sh.P.K., dhe Ndër e Re Mulliri Fushë Kosovë- Podujevë-Lipjan Sh.P.K. në Ceremoninë e sotme të Hapjes së Ofertave. Ky ishte raundi i dytë dhe final i ofertimit.

Për “Spin-offe Speciale” kërkohen dy raunde të Ofertimit.

Sot Ofertat e dyta dhe finale janë pranuar në Zyrën Kryesore të AKM-së në Prishtinë nga ora 10.00 deri në 12.00.

Këto Oferta janë hapur, dhe rezultatet janë postuar në sallën kryesore të konferencave, duke filluar nga ora 13.00.

Rezultatet e Raundit të Dytë të Ofertimit me Spin-off Special – Pikat totale më të larta

NDËR. E RE	Çmimi	Investimi	Punësimi	Ofertuesi
Ndër. e Re Morava e Binçës	€4,117,000	€15,500,000	150	P103
Ndër e Re Mulliri Fushë Kosovë	€2,505,555	€15,000,000	260	P33

Për Ndër. e Re Morava e Binçës Gurëthyesi Sh.P.K. AKM-ja ka pranuar 3 oferta.

Çmimi i ofertës së përkohshme fituese për ofertën e dytë dhe përfundimtare për Ndër. e Re Morava e Binçës Gurëthyesi Sh.P.K. është €4,117,000. Zotimet për investime janë €15,500,000 ndërsa zotimet për punësim janë 150.

Për Ndër e Re Mulliri Fushë Kosovë-Podujevë-Lipjan Sh.P.K., AKM-ja pranoi gjithashtu 3 oferta.

Ofertuesi me shifrën P33, i cili edhe është shpallur fitues i përkohshëm, kishte ngritur çmimin nga €365,000 në €2,505,555. Zotimet për investime ishin ngritur nga €2,200,000 në €15,000,000, ndërsa zotimet për punësim ishin ngritur nga 60 punëtorë në 260 punëtorë.

Për të gjitha shitjet me “Spin-off Special” kërkohet miratimi nga Bordi i AKM-së.